

Republika e Kosovës - Republika Kosovo
 Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
 Drejtoria e Punëve të përgjithshme administrative
 Uprava za Opšte Administrativne Poslove

Pranoh - Primijen
 Pranuor - Primijeno dt. 13.05.18

Numri i Dokumentit	Numri i Biletës	Shtesa	Shënime
01-	413101-	25	886

CESD
 Nr. 14018/2018/1108/2018
 PRISTINE

Memorandum i Mirëkuptimit

për përfshirjen e

Shkollës së Mesme Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë

në implementimin e Projektit –EPIC (Employability & Private businesses Incubator Centre. Easy access to labour market for youth and women), të mbështetur nga Bashkimi Evropian me numër të referencës EuropeAid/155035/DD/ACT/XK me titullin « Mbështetje Arsimit Profesional, Trajnimeve në vend të punës, Vetëpuësimit dhe Ndërmarrësisë » (« Support to Vocational training, On-the-Job training, Self-Employment and Entrepreneurship »)

në mes të

Qendrës për Zhvillim Ekonomik dhe Social (CESD)

dhe

Komuna e Gjakovës e përfaqësuar nga Drejtoria për Arsim

dhe

Shkolla e Mesme Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ("MIM") është lidhur në Gjakovë, më 10 Shtator 2018, në mes të palëve si vijon:

1. **Komuna e Gjakovës ("Komuna")**, njësi e pavarur e vetëqeverisjes lokale, e përfaqësuar në këtë Memorandum nga Drejtoria e Arsimit, me adresë në Gjakovë, rruga Nëna Terezë; dhe

2. **Qendra për Zhvillim Ekonomik dhe Social (CESD)**, organizatë jo-qeveritare e regjistruar në Republikën e Kosovës, me seli në Prishtinë, rruga Gazmend Zajmi;

dhe

3. **Shkolla e Mesme Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë**, shkollë profesionale nën kompetencat e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjakovës;

Së bashku të referuar si "palët";

RECITALET

CESD, Centro Laici Italiani per le Missioni (CELIM), Shkolla e Mesme Teknike "28 Nëntori"- Prishtinë, Shkolla e Mesme e Tregtisë, Hotelerisë dhe Turizmit „7 Shtatori“ - Prishtinë, Shkolla e Mesme Ekonomike „Kadri Kusari“ - Gjakovë, Shkolla e Mesme Teknike „Pjetër Bogdani“ – Ferizaj, (mëtitje "Shkollat"), janë partner në projektin EPIC dhe kanë aplikuar së bashku në thirrjen për aplikim të Bashkimit Evropian **EuropeAid/155035/DD/ACT/XK** me titullin « **Mbështetje Arsimit Profesional, Trajnimeve në vend të punës, Vetëpunësimit dhe Ndërmarrësisë** » («Support to Vocational training, On-the-Job training, Self-Employment and Entrepreneurship»);

CESD, CELIM dhe Shkollat janë shpallur përfitues të grantit përmes të cilit do të organizohen aktivitete të ndryshme për përfitimin e Shkollave, kryesisht në aspektin e pajisjes me pajisje të teknologjisë informative, ofrimin e përkrahjes në revidimin e programeve me nevojat e tregut, mbështetjen e aktiviteteve ndërmarrëse, krijimin e qendrës së inkubacionit, trajnime për nxënësit dhe personelin dhe punë praktike për nxënësit të organizuara nga CESD;

Me qëllim të implementimit të duhur dhe të plotë të projektit, palët dakordohen si vijon:

Neni 1.

Baza ligjore

Neni 5 i LIGJI Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, përcakton se Komunitat kanë Statusin e Personit Juridik. Ky Memorandum i Mirëkuptimit lidhjet nga palët kontraktuese në bazë të Nenit 4 dhe 5 të Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës i cili

përcakton kompetencat e Komunës mbi themelimin dhe administrimin e shkollave, ndër to edhe të Shkollës së Mesme Ekonomike "Kadri Kusari" dhe Nenit 17, parag. 1, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 2. Qëllimi i MIM

1. Qëllimi i këtij Memorandum të Mirëkuptimit është të përcaktoj dakordimin dhe zotimin e të gjitha palëve për implementimin e plotë të projektit në kuadër të **EuropeAid/155035/DD/ACT/XK** me titullin «Mbështetje Arsimit Profesional, Trajnimeve në vend të punës, Vetëpunësimit dhe Ndërmarrësisë» («Support to Vocational training, On-the-Job training, Self-Employment and Entrepreneurship»).

2. Palët zotohen dhe marrin përgjegjësi që në kuadër të kompetencave dhe detyrave të tyre, të ofrojnë të gjithë përkrahjen në aspektin e hapësirave në Shkollë, bashkëpunimit të plotë të personelit dhe menaxhmentit të Shkollës dhe përkrahjen në angazhimin e nxënësve me qëllim të realizimit të aktiviteteve të parapara në projekt.

Neni 3. Aktivitetet që do të zhvillohen në kuadër të Projektit

Në kuadër të implementimit të Projektit EuropeAid/155035/DD/ACT/XK « Mbështetje Arsimit Profesional, Trajnimeve në vend të punës, Vetëpunësimit dhe Ndërmarrësisë », palët dakordohen të bashkëpunojnë në tërësi në zhvillimin e aktiviteteve si vijon:

1. WP1: Krijimi i qendrës për punësim dhe Inkubacion
2. WP2: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet të shkollave të mesme me tregun e punës
3. WP3: Mbështetja e programeve të ndërmarrësisë

Neni 4. Përkrahja nga Bashkimi Evropian dhe zotimi nga palët

1. Projekti EuropeAid/155035/DD/ACT/XK «Mbështetje Arsimit Profesional, Trajnimeve në vend të punës, Vetëpunësimit dhe Ndërmarrësisë » është bashkëfinancim Bashkimi Evropian dhe CESD, në proporcionet 85% me 15%, dhe përfitues përfundimtar nga implementimi i projektit do të jenë Shkollat.

2. Palët zotohen të përkrahin njëra tjetrën në të gjitha aktivitetet e nevojshme për implementimin me sukses të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian.

Neni 5. Objektin shkollor, hapësirat e shfrytëzuara nga shkolla dhe pajisjet e shkollës

Objektet, hapësirat e shfrytëzuara si dhe pajisjet e Shkollës do të jenë në dispozicion të plotë të CESD e cila do të koordinoj implementimin e projektit.

Neni 6. Bartja e pronësisë mbi asetet e projektit

Në rastin kur parashihet në Projekt dhe vendoset nga Bashkimi Evropian, Shkolla do të pranojë si donacion pajisjet e përdorura për implementimin e projektit, përfshirë lloj topin dhe projektorët. Në raste të tilla, një protokoll pranimit-dorëzimit do të nënshkruhet nga partnerët e Memorandumit të Mirëkuptimit.

Neni 7. Përgjegjësia për personelin dhe administrimin e personelit

Përgjegjësia mbi personelin dhe mbi administrimin e personelit për të gjithë të punësuarit në shkollë (mësimdhënës, personel administrativ dhe teknik) është e Komunës, e cila autorizon Drejtorin e Shkollës që të njëjtit t'i lejoj të angazhohen për implementimin e duhur dhe të plotë të Projektit.

Neni 8. Menaxhimi i implementimit të projektit

Buxheti i projektit do të përdoret vetëm për nevojat e realizimit të Projektit, ashtu siç është dakorduar në grantin e Bashkimit Evropian. Implementuesi kryesor i projektit është CESD, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e duhur të të gjitha resurseve të projektit.

Neni 9. Përfshirja e Komunës në aktivitete të projektit

Përfshirja e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjakovës në aktivitetet e projektit në cilësi të monitoruesit është e mirëseardhur gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Në të gjitha eventet promovuese, CESD, CELIM dhe Shkollat do të sigurohen që Komuna të jetë e ftuar dhe të njëjtit të marrin pjesë sipas zgjedhjes së tyre.

Neni 10. Shfrytëzimi i hapësirave të shkollës nga ana e Projektit

Shfrytëzimi i hapësirave të shkollës nga ana e Projektit do të ofrohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij Memorandumi, me kushtin që të njëjtat të mos pengojnë procesin e rregullt mësimor. Orari i shfrytëzimit të tyre duhet të koordinohet me kohë në mes të Drejtorisë së shkollës dhe CESD-së. Parimisht shfrytëzimi nga ana e shkollës profesionale për aktivitete mësimore ka prioritet para nevojave të tjera.

Neni 11. Obligimi për informim i CESD-së ndaj palëve

CESD obligohet që për të gjitha ndryshimet të cilat janë të lidhurat me qëllimet e realizimit të projektit, të njoftoj Shkollën dhe Komunën.

Neni 12. Partneret kontaktues të Shkollës për CESD, për projektin

Persona kontaktues të Shkollës për projektin janë:

- në shkollë, Drejtori i Shkollës;
- në raste kur mungon Drejtori, zv. Drejtori i Shkollës

Neni 13. Personat kontaktues të Komunës për CESD, në lidhje me projektin

Persona kontaktues të Komunës janë

- Drejtori i Arsimit i Komunës së Gjakovës;
- Personi i Deleguar nga Drejtori i Arsimit i Komunës së Gjakovës

Neni 14. Korniza kohore e Memorandumit të Mirëkuptimit


Korniza kohore e Memorandumit të Mirëkuptimit fillon me implementimin e Projektit EuropeAid/155035/DD/ACT/XK "Mbështetje Arsimit Profesional, Trajnimeve në vend të punës, Vetëpunësimit dhe Ndërmarrësisë" i cili përcaktohet si data **10 Shtator 2018** dhe përfundon me realizimin e plotë të aktiviteteve të parapara në projekt.

Neni 15. Korniza kohore e Memorandumit të Mirëkuptimit

Pjesë e zbatimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë edhe projekt propozimi i dorëzuar nga CESD, CELIM dhe Shkollat dhe i aprovuar nga Bashkimi Evropian dhe të gjitha dokumentet e projektit të ndërlidhura me zbatimin e plotë të tij.

Z. Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës



Z. Arbër Reçi

Drejtor Ekzekutiv në CESD



Znj. Merita Bokshi

Drejtoreshë e SHME "Kadri Kusari" Gjakovë

